

**Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Partner Hotel” shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2023)**

---

**Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Partner Hotel” shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2023)**

**21 Mars 2024**



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Partner Hotel” shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2023)**

---

### **Informacion i përgjithshëm.**

Shoqëria “Partner Hotel” shpk është themeluar date 23.09.2022, regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlore, me nipt M27123201F.

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare” i ndryshuar, nga statuti dhe Legjislacioni ne fuqi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë “Partner Hotel” shpk është: Sherbim hotelerie, akomodim, bar-restorant, salla konferencash. Aktivitet ne fushen e turizmit, hapja dhe menaxhimi i hoteleve e godinave dhe ambiente te tjera ne funksion te turizmit.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është zj. Eralda Murataj. Selia e Shoqërisë është në Lagjia Pavaresia, Rruga Pelivan Leskaj, Zona Kadastrale Nr.8602, Hotel Partner, kati i pare, Vlore.

### **Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

**Deklarata e pajtueshmërisë:** Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**Bazat e matjes:** Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

**Biznesi në vijimësi:** Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

**Monedha funksionale dhe e paraqitjes:** Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Leke, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

**Vlerësime dhe gjykime:** Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

**Zhvlërësimi i llogarive të arkëtueshme:** Zhvlërësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Partner Hotel” shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2023)**

e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

**Provizionet:** Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

**Krahasueshmëria e informacionit kontabël:** Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

### **Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

Transaksionet në monedhë të huaj.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2023	2022
Euro/LEK	103.88	114.23
USD/LEK	93.94	107.05

### **Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Partner Hotel” shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2023)**

fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogarituri mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përfaqësohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

### **“Partner Hotel” shpk (Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2023)**

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### **Aktive afatgjata materiale**

##### **i. Njohja dhe matja**

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Partner Hotel” shpk**  
**(Për ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2023)**

---

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

### iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

### Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

### Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

### Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

### Të ardhurat dhe shpenzimet financiare



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Partner Hotel” shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2023)**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### **Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t’u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t’u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2023 është 15% (2022: 15%), ndonese shoqëria për këto ushtrim është me humbje.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

### **Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

### **Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Partner Hotel” shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2023)**

---

### Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

### Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

## **AKTIVET AFATSHKURTRA**

**Aktive monetare** për 11.800.591 lekë, perfaqesojne mjete monetare ne banke.

Shoqëria operon me disa banka leke dhe euro, te gjitha veprimet jane rregjistruar ne ditaret perkates, me llogarite ne valute veprimet jane kryer me kursin ditor te bankes, ndersa gjendja e monedhave te huaja ne fund te ushtrimit eshte vleresuar me kursin e Bankes se Shqiperise me date 31.12.2023 duke kaluar sipas rastit ne llogarite e shpenzimeve apo te ardhurave diferencat e kembimit.

**Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit** në vlerën 615.730 leke perfaqeson llogarine Kliente per vleren e faturave te paarketuara. Kjo llogari eshte e analizuar sipas klienteve dhe rakordon me llogarine sintetike te tyre.


**Te tjera te drejta te arketueshme** ne shumen 1.773.481 leke paraqesin Tvsh.

**Gjendjet inventariale** ne shumen 2.839.580 leke paraqesin gjendjen e mallrave date 31.12.2023, stoku mbahet me inventar te perhershem, gjendja e tyre ne fund te ushtrimit eshte vleresuar me kosto blerje.

Parapagime per inventar ne shumen 572.163 leke.

### **Aktivitet afatgjata materiale**

Shoqëria ka një vlerë neto aktivesh afatgjata materiale ne shumen 457.495.929 lekë, te cilat perfaqesojne vleren e blerjes se mjeteve te punes, pajisjeve te zyres dhe informatikes. Aam jane shtuar nga blerjet ne shumen 473.664.129 leke te cilat perfaqesojne vleren e truallit dhe te hotelit, Aam jane pakesuar per amortizimin e llogaritur ne shumen 17.960.493 leke.





## Shenime mbi pasqyrat financiare

**“Partner Hotel” shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2023)**

### DETYRIMET DHE KAPITALI

**Kapitalet e veta** paraqiten me vlerë 10.995.990 leke.

**Kapitali i rregjistruar i shoqërisë** është 1.000 lekë, i perbere nga nje kuote e cila i perket ortakut te vetem te shoqerise zj. Eralda Murataj.

Fitimi i mbartur ne shumen 2.979.221 leke, paraqet fitimin e vitit 2022.

**Fitmi i ushtrimit** sipas bilancit kontabël paraqitet ne shumen 8.015.769 lekë.

#### Detyrimet

Detyrimet me vlerë 464.101.484 lekë përfaqësojnë:

	<u>Viti 2023</u>	<u>Viti 2022</u>
Detyrime ndaj institucioneve te kredise	285.981.130	
Arketime ne avance per porosi		
Te pag. per aktivitetin e shfrytezimit	146.632.610	229.926
Te pag.ndaj punonj.e sigurimeve shoqerore	1.177.535	723.709
Detyrime tatimore	262.353	527.045
Te tjera detyrime	30.047.856	9.756.444
<b>Totali</b>	<b>464.101.484</b>	<b>11.237.124</b>

**Detyrime ndaj institucioneve te kredise** ne shumen 285.981.130 leke, paraqet hua te marre ne Credins banke.

**Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit** per 146.632.610 leke paraqesin llogarine furnitore per vlerën e faturave të palikujduara.

**Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore** paraqitet detyrimi i shoqerise per paga ne shumen 964.658 leke dhe ndaj sigurimeve ne shumen 212.877 leke.

**Detyrime tatimore** ne shumen 262.353 leke paraqesin Tatim fitimi.

**Te tjera kerkesa** ne shumen 30.047.856 leke paraqet detyrim te shoqerise ndaj te treteve.

#### Verifikimi i llogarise Fitime Humbje

Shpenzimet dhe të ardhurat janë grupuar si më poshtë:

	<u>Viti 2023</u>	<u>Viti 2022</u>
<b>Te ardhura</b>		
Nga shitja e mallrave dhe sherbimeve	87.076.753	11.069.691
Shtimi i gjendjes se produktit te gatshem		
<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>87.076.753</b>	<b>11.069.691</b>
Pakesim i gjendjes se produktit te gatshem		
Materiale te konsumuara	39.171.084	4.497.177
<b>Kosto e punes</b>	<b>10.136.295</b>	<b>2.098.039</b>
Pagat e personelit	8.685.771	1.797.806
Shpenzimet per sigurime	1.450.524	300.233
Amortizimi dhe zhvleresimet	17.960.493	34.706
Shpenzime te tjera	9.512.569	863.970



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

### **“Partner Hotel” shpk (Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2023)**

<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>76.780.441</b>	<b>7.493.892</b>
Te ardhura te tjera		
Te ardhura/shpenzime interesa	(11.346.401)	
Diferencat nga kembimi	10.511.138	(70.833)
<b>Fitimi bruto</b>	<b>9.461.049</b>	<b>3.504.966</b>
<b>Tatim fitimi</b>	<b>1.445.280</b>	<b>525.745</b>
<b>Fitimi neto</b>	<b>8.015.769</b>	<b>2.979.221</b>

Shpenzimet jane 88.126.842 leke, ndersa te ardhurat 97.587.891 lekë. Rezultati neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj gjate ketij viti ushtrimor është fitim ne shumen 8.015.769 leke. Te ardhurat e realizuara gjate ushtrimit perfaqesojne: te ardhura nga shitja e sherbimeve ne shumen 87.076.753 leke dhe diferenca kembimi ne shumen 10.511.138 leke. Shitjet jane rregjistruar korrekt ne librat e shitjeve dhe te ardhurat rakordojne me situaten tatimore.

**Shpenzimet** per 88.126.842 lekë, jane te justifikuara me dokumenta te rregullta fiskale. Më konkretisht shpenzimet sipas zërave janë:

**Shpenzimet per materiale** ne shumen 39.171.084 leke, ato janë përdorur për veprimtarinë kryesore të shoqërisë, këto shpenzime janë të justifikuara me dokumenta te rregullta tatimore

**Personeli**, në këtë llogari janë pasqyruar shpenzimet për paga 8.685.771 lekë, sigurime shoqërore 1.450.524 lekë, listëpagesat janë përpiluar saktë dhe shpenzimet për paga e sigurime janë vendosur korrekt në këtë llogari. Nr mesatar i punonjesve eshte 19.

**Amortizimi** ne shumen 17.960.493 leke.

**Shpenzime te tjera** per 9.512.569 leke paraqesin:

- shpenzime komisioni banke ne shumen 317.200 leke,
- shpenzime per energji elektrike 5.607.229 leke,
- trajtime te pergjithshme ne shumen 2.200.792 leke,
- shpenzime telefoni ne shumen 279,675 leke,
- shpenzime te poanjohura ne shumen 174.152 leke,
- shpenzime taksa lokale ne shumen 672.764 leke,
- transporti ne shumen 213.174 leke,
- shpenzime te tjera ne shumen 47.583 leke.

**Shpenzime financiare** ne shumen 11.346.401 leke paraqesin shpenzime interesa.

**Rezultati ushtrimor** neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj është fitim 8.015.769 leke.

#### **Çeshtje gjyqesore**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 20223 Shoqëria nuk ka asnje



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Partner Hotel” shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2023)**

---

çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

### **Ngjarje pas datës së Bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Pasqyrat financiare jane përgatitur mbi supozimin e biznesit në vijimësi, dhe drejtimi mendon se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

**Hartuesi i pasqyrave financiare**  
Orkida Hoxhaj

Orkida Hoxhaj



**Administratore**  
Eralda Murataj

Eralda Murataj

